

në makinë të tipit *Golf II*, ngjyrë ari. Kur vëllai i Ramizit, Hajrizi, nisi të kundërshtonte për një veprim të tillë, pjesëtarët e UÇK-së e morën me vete edhe atë dhe të birin Ejupin. Hajrizin dhe Ejupin i liruan në afërsi të varrezave të fshatit, te dalja nga Bellanica/Belanica. U thanë se Ramizin do ta çonin në Timiqinë/Timiçina, për shkak të marrjes së tij në pyetje rreth imamit. Por, Ramizi dhe Ejupi vunë re se makina u nis në drejtim të Kravasarisë/Kravoserija. Menjëherë pas kësaj, i biri i Ramizit, Enveri, dhe ai i Hajrizit, Ejupi, u nisën për ta kërkuar Ramizin. Pranë rrugës që çon drejt fshatit Banjë/Banja, i kanë gjetur trupat e të pajetë të Ramizit dhe Selman Binishit [të shikohet regjistrimi në vazhdim]. Ishin ekzekutuar me plumba në gjoks. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Ramizin në varrezat e Bellanicës/Belanica.

Burimet: deklarata E.H, FDH-15978; *Objava vojne policije OVK br. 4, Saslušanje održano u istražnom pritvoru br. 3, FDH-16696; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 14.02.2005, 15, 16, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj-%20svedok%20Jakup%20Krasniqi%20-14.02.%202005..pdf>; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz, pyetësor, FDH-31242.**

Selman (Asllan) Binishi

(20.9.1970, shqiptar nga Banja, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, tre fëmijë)

Selmani ka qenë punëtor ndërtimor. Jetonte me vëllezërit e vet dhe familjet e tyre në *Mëhallën Binishi* në Banjë/Banja. Në datën 2. 10. 1998, e gjithë familja ka shkuar në arë për të nxjerr patate. Rreth mesditës [2.10.1998], Selmani u nis me traktor në fshatin fqinj të **Bellanicës/Belanica**, për të blerë karburante. Pas shkuarjes së tij, vëllezërit e tij i dëgjuan të shtënat, por nuk u kushtuan rëndësi. Dy orë më vonë, erdhi kushëriri Nazmiu dhe u bëri të ditur se persona të panjohur e kishin rrëmbyer Selmanin në Bellanicë/Belanica dhe se pas kësaj e kishin vrarë përkaj rrugës mes Banjës/Banja dhe Kravasarisë/Kravoserija. Vëllezërit shkuan menjëherë te vendi në fjalë dhe atje e gjetën trupin e pajetë të Selmanit. Pranë tij ishte

edhe trupi i Ramiz Hoxhës [të shikohet regjistrimi i mëparshëm]. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Selmanin në *Mëhallën Binishi* në Banjë/Banja. Pas lufte, më 30.05.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Selmanit në varrezat e Banjës/Banja.

Burimet: deklarata N.B, FDH-34636; deklarata E.H, FDH-15978; *Objava vojne policije OVK br. 4, Saslušanje održano u istražnom pritvoru br. 3, FDH-16696; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 14.02.2005, 15, 16, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj-%20svedok%20Jakup%20Krasniqi%20-14.02.%202005..pdf>; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz, pyetësor, FDH-31242.**

Dejan (Branko) Barać

(22.04.1972, serb nga Kragujevci, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dejani e ka mbaruar shkollën e mesme të makinerisë. Pastaj e kreu edhe trajnimin për oficer policie. Në datën 29.06.1992, ai nisi nga puna në MPB-në e Serbisë. Në muajin tetor të vitit 1998, gjendej me detyrë në Kosovë. Në datën **3.10.1998**, rreth orës 16:30, Dejani rastisi të ishte në postbllokun policor në **Dragobil/Dragobilje**, kur pjesëtarët e UÇK-së e kryen një sulm kundër këtij punkti të forcave serbe. Më këtë rast, Dejani gjeti vdekjen gjatë shkëmbimit të zjarrit.

Burimet: SMIP, *Teroristički...*, III, 941; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 13; *Dnevnik od 30. septembra do 5. oktobra*, Ilustrovana politika, FDH-32305; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832.

Nenad (Tihomir) Stanković

(25.07.1970, serb nga Ribari, komuna e Jagodinës, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Nenadi me origjinë ka qenë nga Leshtari/Lještar [Kamenicë/Kosovska Kamenica]. Pas mbarimit të shkollës së mesme për punë të brendshme, Nenadi u punësua në SPB-në e Jagodinës. Gjatë vitit 1998, disa herë e çuan me detyrë në Kosovë. Herën e fundit ka shkuar atje më 13.10.1998. Nenadin e kanë plagosur më **15.10.1998**, rreth orës 17:45, në **Dragobil/Dragobilje**. E kishin